



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional

“Arkitekture Peisazhi”

i

**Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Bujqësor i
Tiranës”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr. Gjergj THOMAI
2. Dr. Petrit HARASANI


Shtator/2019

PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit të Ciklit të Dytë “Master Profesional në Arkitekturë Peisazhi” ka nisur në vitin akademik 2013-2014 me vendim të Këshillit të Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit nr. 19, datë 17 Dhjetor 2012 dhe vendim të Senatit Akademik të Universitetit Bujqësor të Tiranës nr. 38, datë 27 Dhjetor 2012, dhe Urdhrin e Ministrisë për licencimin UMASH Nr. 208, datë 31.05.2013 pranë Departamentit të Hortikulturës i cili pas fillimit të këtij programi mori emrin Departamenti i Hortikulturës dhe Arkitekturës së Peisazhit. Programi zhvillohet në bashkëpunim me Fakultetin e Arkitekturës të Universitetit Politeknik të Tiranës.

Programi u ofron studentëve dije për zhvillimin e profesionit të arkitektit të peisazhit, në të cilin integrohen njohuri dhe kompetenca në fushën e projektimit dhe menaxhimit të peisazhit me aftësitë për të bashkëpunuar me profesione të tjera të sektorit të arkitekturës, inxhinierisë dhe të shkencave natyrore e agronomike.

Objektivi kryesor i programit është të plotësojë kërkesat në rritje të tregut të punës për specialistë në fushën e planifikimit, projektimit, ndërtimit dhe mirëmbajtjes së mjediseve të gjelbëruara rezidenciale dhe të parqeve publike.

Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm; 200 fjalë

Grupi i Eksperteve të Vlerësimit të Jashtëm përbehet nga dy anëtare: Dr. Gjergj THOMAI dhe Dr. Petrit HARASANI, me pjesëmarrjen edhe të znj. Juna MENGRI, koordinatore e ASCAL për këtë program studimi.

Procesi i vlerësimit të jashtëm filloi gjatë muajit Maj 2019. Vizitat në UBT u kryen në datat 30-31 Maj 2019. Takimet u kryen në perputhje me agjenden e vizites te miratuar nga ana e ASCAL dhe UBT. Vlerësimi i Jashtëm u krye në perputhje me udhëzimet dhe dokumentacionin ndihmës të ASCAL si edhe nga dokumentacionet (të një numri shumë të madh dokumentësh plane, statutë, rregullore, raporte, etj.). e vena në dispozicion nga strukturat përkatëse të MP-“Arkitekture Peisazhi” në UBT. Ky vlerësim u mbështët edhe në takimet me grupet të ndryshme në UBT si dhe përvojës së Grupit të Ekspertëve të Vlerësimit të Jashtëm në fushën e vlerësimit të programeve mësimore si dhe mesimdhënies. Vlerësimi ka për qëllim që të përcaktojë nivelin e plotësisht të standardeve të akreditimit nga programi i studimeve të ciklit të dytë “Mastër Profesional në Arkitekturë Peisazhi”. Nëpërmjet këtij procesi duhet të identifikohen pikat e forta dhe të dobëta, problemet dhe mundësitë e këtij programi të cilat do të shërbejnë për të përmirësuar punën në të ardhmen.

Më datë 09.07.2019, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 44/43 Prot., dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. Më datë 09.09.2019, nëpërmjet sistemit AMS, Institucioni përcjell përgjigjen mbi Draft-Raportin, përmes së cilës shpreh dakordësinë me të gjitha gjetjet dhe konkluzionet e raportit. I vetmi koment me sygjërimin e rishikimit ka të bëjë me përmbushjen e Standardit IV mbi burimet njerëzore financiare infrastrukturën. Institucioni sugjeron rishikimin dhe vlerësimin e shkallë s së përmbushjes nga I Përmbushur Kryesisht në I Përmbushur Plotësisht duke e bazuar në:

Institucioni ynë po punon për zhvillimin e kapaciteteve humane për këtë program në bashkëpunim me Fakultetin e Arkitekturës të UPT.

Përveç kësaj në këtë program studimi, përveç programeve të zakonshme të kualifikimit, ka një marrëveshje të veçantë me Universitetin e Geisenheim në Gjermani, ku Institucioni këto ditë ka kurorëzuar edhe rekrutimin e një asistenti lektori (arkitekt) më moshë të re,

Nga ana tjetër, në lidhje me përdorimin e teknologjive të reja, veç të tjerave, Institucioni ka një marrëveshje të veçantë me autoritetin shtetëror të Informacionit Gjeohapësinor e cila adreson pikërisht këtë problematikë:

Përgjigja e GVJ: Ekspertët e vlerësimit përshëndesin dhe mbështesin punën në vazhdim të ndërmarrë nga ky institucion për rritjen e kapaciteteve në të ardhmen. I gjithë vlerësimi i GVJ është mbështetur në dokumentacionin e ardhur në DVV por edhe në gjetjet gjatë vizitës dy ditore në UBT. Për këtë arsye, GVJ nuk ndryshon vlerësimin për Fushën IV.

Sa më lart, Draft-Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional “Arkitekture Peisazhi”

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë “Master profesional” në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional “Arkitekturë Peisazhi” është pershtatur sipas zhvillimeve social-ekonomike të vendit me kërkesen për më shumë hapësira të gjelbëruara, kopshte e parqe urbanë si dhe ndjeshmërinë e lartë të publikut për këtë nevojë. Interesi kombëtar i vendit në këtë fushë është në përputhje me Ligjin Nr. 87/2016 dt 8 Shtator 2016 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën europiane të peizazheve”. (Statuti I UBT dhe Takimi me Dekanin)
Kriteri 2 Programet e studimit synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimeve “M.P.në Arkitekturë Peisazhi” është mbështetur në përvojën e gjatë akademike të UBT në fushën e botanikës, lulëtarisë, dendrologjisë, ekologjisë etj. Dhe plotësuar me kontributet e Fakultetit të Arkitekturës në Universitetin Politeknik të Tiranës. Programi është mbështetur që në fillim në përcaktimet e Konventës Europiane të Peisazhit e cila kërkon që të nxitet e të çohet përpara mbrojtja, menaxhimi dhe planifikimi i peizazheve, të organizohet një bashkëpunimin në nivel rajonal dhe evropian si një element i rëndësishëm për cilësinë e jetës së popullsisë në mjediset urbane e rurale, duke përcaktuar objektiva për rritjen cilësore të peizazheve. Si dhe zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit (takimi me dekanin, stafin akademik si dhe marrëveshje bashkëpunimi UBT-UPT)
Kriteri 3 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit “Master Profesional në Arkitekturë Peisazhi” është në përputhje të plotë me misionin dhe qëllimin e UBT, Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit dhe Departamentit të Hortikulturës dhe Arkitekturës së Peisazhit. (Statuti I UBT dhe Takimi me Dekanin si dhe Plani Strategjik 2016 – 2025)
Kriteri 4 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Programi i studimit “Master Profesional në Arkitekturë Peisazhi” përmban objektiva me zhvillimin ekonomik të vendit në sektorë si kopshtaria, zhvillimi i qëndrueshëm urban dhe rural, turizmi dhe agroturizmi dhe shërbimet e gjelbërimit urban e më gjerë. Ky program synon të ofrojë një shërbim arsimor në nivelin më të lartë në fushën e Arkitekturës së Peisazhit nëpërmjet një

	kurrikule koherente me nevojat e tregut (Statuti I UBT dhe Takimi me Dekanin si dhe Plani Strategjik 2016 – 2025)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Në strategjinë e UBT është zgjerimi i ofertës studimore nëpërmjet edhe Programit Master Profesional në Arkitekturë Peisazhi. në RVB permendet se ky program “është në linjë edhe me iniciativën e UBT (FEA dhe FBM) për hapjen e një Masteri Ekzekutiv në Planifikim dhe Zhvillim Territori”. Programi “Master Profesional në Arkitekturë Peisazhi” ka si qëllim të ofrojë mundësi për arsim cilësor në funksion të karrierës në arkitekturë peisazhi. Ne statutin dhe strategjinë e institucionit duhet të percaktohet qartë strategjia e zhvillimit të ketij programi, lidhur edhe me programet e tjera, si dhe linjen e planifikimit të territorit (Statuti I UBT dhe Takimi me Dekanin, takimi me stafin akademik si dhe Plani Strategjik 2016 – 2025)
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	UBT i ka dhënë rëndësi rritjes së peshës së moduleve në fushën e Arkitekturës së Peisazhit. UBT ka nisur me disa dokumenta strategjikë që lidhen me bujqësinë dhe zhvillimin rural që i japin përparësi formimit profesional në hortikulturë dhe arkitekturë peisazhi. Ne gjykimin tone duhet që Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij.
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Fusha e studimit “Arkitekturë Peisazhi” referohet si fushë studimi e veçantë në nenin 2 dhe 59 të Statutit të UBT. Në sajë të një marrëveshje bashkëpunimi me UPT, UBT shprehet se duke mos patur akoma ekspertizë të mjaftueshme siç janë ato të projektimit apo të ndërtimeve në peizazh, ato do mbulohen nga stafi i fakultetit të Arkitekturës UPT. (RVB, Marrëveshje UBT-UPT)
Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional” hartohen e zhvillohen në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.	Programi është mbështetur në eskperiençen në nivel botëror nga Federata Ndërkombëtare e Arkitektëve të Peisazhit (IFLA) dhe e pranuar si profesion i regjistruar nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO). Megjithatë arkitektura e peisazhit është një disiplinë e re. Me këtë program studimi kurrikula akademike të d.HAP është përafëruar më shumë me atë të departamenteve analoge në universitetet më të mira në botë

	dhe me tendencat aktuale të zhvillimit të tyre në përgjithësi. (RVB, Takimi me Dekanin si dhe stafin akademik)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.3
Programet e studimit “Master profesional” synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit “Master profesional” kanë objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Program i studimit “Master Profesional në Arkitekturë Peisazhi” ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës dhe vecanerisht në zbatim të rekomandimeve të Konventës Europiane të Peisazhit (Firenze, 2000) lidhur me formimin e specialistëve në sektorin e njohjes dhe ndërhyrjes në peizazh si dhe aktivizimin e studimeve universitare që trajtojnë vlerat e lidhura me peisazhin dhe ato që trajtojnë ruajtjen, menaxhimin, planifikimin dhe projektimin e tyre me qëllim rritjen e njohjes për peizazhet. (RVB, takimet me Dekanin, Stafin Akademik)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Ne hapjen e programit është bërë një vlerësim i përgjithshëm i tendencave të tregut. Qendra e Karrierës dhe Alumnit (QKA) ka ndërtuar një database të studentëve që diplomohen në UBT me synimin për të ndjekur punësimin e tyre deri në pesë vjet. Procesi i ndërtimit të portalit interaktiv të QKA është në fazën e fillimit të tij.</p> <p>Nevojat e sektorit për profesionistë të diplomuar janë të njohura nëpërmjet disa studimeve të tërthorta për tregun e punës, pra të dhëna dytësore. (Raport për aktivitetin e QKA, takimi me QKA, RVB, takimi me studentët, takime me stafin akademik).</p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të nxënimit garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Objektivat dhe përmbajtjet e programeve të studimit lidhur me pritshmerinë e të nxënimit pretendojnë të garantojnë përfitimin e aftësive dhe kompetencave për tju përgjigjur tregut të punës dhe lehtësimin të punësimit të studentëve.</p> <p>Stafi akademik i Departamentit mban marrëdhënie të vazhdueshme me bizneset e fushës duke mundësuar edhe ndjekjen e studentëve që janë punësuar në këto biznese. Nga ana tjetër, shumë prej ish-studentëve ruajnë</p>

	marrëdhëniet me departamentit. (takimi me stafin akademik, takimi me studentët)			
Kriteri 4. Programet e studimeve përafrohen me programe studimi të ngjashme të ofruar nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimit të studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.	Hartimi i kurrikulës së këtij programi është bazuar në studimin e kurrikulave në disa universitete të ndryshme të botës si dhe mbështetet edhe në përvojën e krijuar në UBT për disa dekada me radhë në fushën bujqësore. Programi mbështetet në përcaktimet e Konventës Europiane të Peisazhit e cila kërkon që të nxitet e të çohet përpara mbrojtja, menaxhimi dhe planifikimi i peizazheve (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me stafin Akademik)			
Kriteri 5. Programet e studimit hartohen në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara mbështeten në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikat e mira të vendeve evropiane.	Programi është mbështetur në nivel evropian në dy procese: Parimet e njohjes profesionale të shtrua nga Direktiva e Kualifikimit Profesional (Direktiva 2005/36/EC) dhe njohja profesionale nga IFLA- Europë. Në nivel kombëtar njohja dhe akreditimi ndryshojnë sipas rregulloreve që ka çdo vend. Marrëveshja e bashkëpunimit me Universitetin e Geisenheim në Gjermani ka për qëllim ta mbështesë këtë proces (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me stafin Akademik)			
Kriteri 6. Programet e ciklit të dytë “Master profesional” përfshijnë aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.	Programi i ciklit të dytë “Master Profesional në Arkitekturë Peisazhi” përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me stafin Akademik, Takimi me studentët)			
Kriteri 7. Në varësi të profilit të institucionit, në programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin.	Programi i ciklit të dytë “Master profesional në Arkitekturë Peisazhi” përfshin një semestër i cili mund të zhvillohet në gjuhën angleze. Gjatë vitit akademik 2016-2017 është përgatitur një program i veçantë në anglisht në arkitekturë peisazhi në kuadër të programit Erasmus + për një studente nga Universiteti i Gisenit, Gjermani.			
Kriteri 8. Programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të hapen përkohësisht në funksion të plotësimin të nevojave për personel të kualifikuar në një drejtim të caktuar.	Programi i studimit i ciklit të dytë “Master Profesional në Arkitekturë Peisazhi” i themelua si nevojë e kërkesave të tregut për plotësimin e nevojave për specialist në fushën e projektimit të peisazhit. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me stafin akademik)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.4

Programet e ciklit të dytë “Master profesional” janë në përputhje me fushën akademike të njesisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Njësia bazë, përgjegjëse për programin e studimit “Master Profesional në Arkitekturë Peisazhi” është Departamenti Hortikulturë dhe Arkitekturë Peisazhi. Ky departament ka një personel akademik 9 profesorë dhe 3 profesorë të asociuar. Përvoja e stafit akademik është e lartë (mesatarisht 19 vjet përvojë punë pedagogjike). Mangësitë e përkohëshme që ka UBT në kolonën për disiplina shumë të specializuara të arkitekturës së peisazhit në këtë program plotësohen në sajë të bashkëpunimit me Fakultetin e Arkitekturës të Universitetit Politeknik të Tiranës. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me stafin akademik, Të dhëna mbi personelin akademik të FBM)			
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Programi i studimit “Master Profesional në Arkitekturë Peisazhi” është ndër programet më të reja të Universitetit Bujqësor të Tiranës. Në hartimin dhe rishikimin e programit të studimit “Master Profesional në Arkitekturë Peisazhi” janë mbajtur parasysh dokumenta si: LE: NOTRE, EU-teach, EU-Land21 etj. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me stafin akademik)			
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Arkitektura e peisazhit mbështet në 4 kolona kryesore të cilat janë: arti/estetika, teknologjia, sistemet natyrore dhe sistemet humane. Kjo ka kërkuar një bashkëpunim të ngushtë midis Departamentit të Hortikulturës dhe Arkitekturës së Peisazhit dhe Departamenteve të tjera në FBM dhe të Fakulteteve të tjera brenda UBT. Mangësitë e përkohëshme që ka UBT në kolonën arti/estetika në këtë program plotësohen në sajë të bashkëpunimit me Fakultetin e Arkitekturës të Universitetit Politeknik të Tiranës. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me stafin akademik)			
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program të ciklit të dytë “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	Mangësitë plotësohen në sajë të bashkëpunimit me Fakultetin e Arkitekturës të UPT. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me stafin akademik)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisive e personelit, marrjes së përgjegjësisive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Administrimi i programit të studimit “Master Profesional në Arkitekturë Peisazhi” realizohet kryesisht nëpërmjet rregulloreve të brendshme, mbështetur në ligjin për aarsimin e larte. Dokumente të tjera që përmbajnë elementë të përgjegjësisive respektive dhe analizës së punës janë vendimet e rektoratit në formën e planit të masave. (RVB, Ligji për Arsimin e Lartë, Statutii UBT, Rregullorja e Studimeve e FBM)</p>			
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Për mbështetjen e realizimit të objektivave të programit të studimit “Mastër Profesional në Arkitekturë Peisazhi” janë realizuar dhe funksionojnë marrëveshje bashkepunim midis Universitetit Politeknik të Tiranës dhe Universitetit Bujqësor të Tiranës. Po kështu në funksion të realizimit të procesit mësimor, UBT ka një marrëveshje me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. etj. (RVB, Takimi me Dekanin, Marrëveshjet e Bashkepunimit)</p>			
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programeve të ciklit të dytë “Master profesional”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute, kompani, të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>UBT ka marrëveshje bashkëpunimi me Bashkinë Tiranë në projekte të Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit, me MEGATEK sh.a.etj. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me studentët, Marrëveshjet e Bashkepunimit)</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimit që ofron.</p>	<p>Departamenti ka bashkëpunime edhe me një sërë biznesesh të tjera në fushën e prodhimit të luleve dhe bimëve zbukurorese, të perimeve, frutave, etj. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Studentët, Udhëzuesit për Praktikën Profesionale)</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Institucionin nuk ofron trajnime profesionale (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Studentët)</p>			
<p>Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Departamenti nuk harton nje raport per perfitimet nga Marrëveshjet e Bashkepunimit, si Studion e Arkitektures që Megatek i ka dhuruar Departamentit. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Studentët)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	---

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL

Standardi II.1 Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1 Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit “Master Profesional Arkitekturë Peisazhi”, është i mbështetur në legjislacionin në fuqi për organizimin në module dhe vlerësimin në kredite. (RVB, Takimi me Dekanin, Rregullorja e Studimeve të UBT).
Kriteri 2 Programet e studimit të ciklit të dytë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.	Kurrikula e programit të studimit “Arkitekturë Peisazhi” është hartuar në përputhje me nevojat e specialiteteve sipas moduleve ku te mund të punojnë në sektorin publik dhe privat në fusha që lidhen me planifikimin e peisazhit, projektimin e sistemeve të gjelbra urbane, projektimin e parqeve e kopshteve, projektimin e zonave të hapura urbane, projektimin dhe ndërtimin e këndeve të lojërave për fëmijë dhe komplekseve sportive, rikualifikimin dhe riparimin e zonave të degraduara, etj. (RVB, Takimi me Dekanin, Takim me Stafin Akademik, Takim me Studentët).
Kriteri 3 Programet e studimit të ciklit të dytë japin njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	“Master Profesional në Arkitekturë Peisazhi” karakterizohet nga ndërgjegjësimi dhe respekti për natyrën si dhe njerëzit e nevojat e tyre. (RVB, Takimi me Dekanin, Takim me Stafin Akademik, Takim me Studentët).
Kriteri 4 Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Programi i studimit karakterizohet nga aftësia për të integruar dimensionet artistike, shkencore, kulturore, institucionale, sociale, ekologjike dhe teknologjike në projektimin, planifikimin dhe manaxhimin e peizazheve. (RVB, Takimi me Dekanin, Takim me Stafin Akademik, Takim me Studentët).
Kriteri 5 Programet e studimit të ciklit të dytë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	Plani mësimor dhe aktivitetet e tjera formuese janë në përputhje me kriteret e përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore dhe mundësojnë formimin e specialistëve të aftë për të përballuar nevojat e tregut të punës. (RVB, Takimi me Dekanin, Takim me Stafin Akademik, Takim me Studentët).
Kriteri 6 Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtarisë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Modulet janë të përcaktuara sipas veprimtarisë formuese dhe kjo është e shënuar në silabusin e modulit. Mbi këtë bazë është bërë edhe përcaktimi i krediteve. (RVB, Takimi me Dekanin, Takim me Stafin Akademik, Takim me Studentët, Syllabuset).

<p>Kriteri 7 Programet e studimit parashikojnë ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale, laboratorike e klinike me ekuivalentim sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane.</p>	<p>Programi përfshin aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit. Gjatë semestrit të fundit të studimeve parashikohen 6 javë mësimore praktikë profesionale të cilat vlerësohen më 6 kredite dhe përfaqësojnë 180 orë mësimore. (RVB, Takimi me Dekanin, Takim me Stafin Akademik, Takim me Studentët, Syllabuset, Praktikat).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi II.2 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Njësia bazë përgjegjëse për programin “Master Profesional në Arkitekturë Peisazhi” është Departamenti i Hortikulturës dhe Arkitekturës së Peisazhit. Departamenti përmbush kriteret e Nenit 25 Neni 25 Ligji 80/2015, pasi ka në përbërje 12 personel akademik efektiv (me kohë të plotë); 9 profesorë dhe 3 profesorë të asociuar. (RVB, Takimi me Dekanin, Takim me Stafin Akademik, Takim me Studentët, CV stafit).</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Departamenti i Hortikulturës dhe Arkitekturës së Peisazhit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. Ai është i organizuar në dy grupe mësimore – kërkimore (GMK): ‘Hortikulturë’ dhe ‘Arkitekturë Peisazhi’. Departamenti ka 2 personel ndihmës akademik Personeli ndihmes akademik asiston në pret e praktikave dhe te laboratoreve. (RVB, Takimi me Dekanin, Takim me Stafin Akademik, Takim me Studentët, struktura e departamentit).</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>Kjo njësi përmbush detyrimet që rrjedhin nga aktet ligjore dhe nënligjore duke ushtruar kompetenca të plota mbi mbarëvajtjen e mësimit dhe kërkimit, siç përcaktohet edhe në rregulloren e studimeve të UBT, si dhe raportin e PAE/PAK (RVB, Takimi me Dekanin, Takim me Stafin Akademik, Evidencë analizuese për përmbushjen e numrit dhe kualifikimeve).</p>
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Mbështetur në Ligjin 80/2015, përgjegjësi i departamentit është njëherazi edhe koordinator i programeve të studimit. (RVB, Takimi me Dekanin, Takim me Stafin Akademik, Lista e pedagogëve këshillues/kujdestarë).</p>
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike.</p>	<p>Departamenti ka 2 personel ndihmës akademik me përvojë që asistojnë në procesin mësimor, veçanërisht në orët e praktikave. (RVB, Takimi me Dekanin, Takim me Stafin Akademik, Lista e stafit ndihmes).</p>

Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Mbështetur në Ligjin 80/2015, përgjegjësi i departamentit është njëherazi edhe koordinatori i programeve të studimit. (RVB, Takimi me Dekanin, Takim me Stafin Akademik, Lista e pedagogëve këshillues/kujdestarë)
--	--

Kriteri 7. Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njesise përgjegjese dhe dokumenton informacionin që lidhet me programin e studimit. (RVB, Takimi me Dekanin, Takim me Stafin Akademik, Lista e pedagogëve këshillues/kujdestarë Evidencë analizuese për përbushjen e kerkesave)	Koordinatori raporton në menyre periodike te drejtuesi i njesise përgjegjese dhe dokumenton informacionin që lidhet me programin e studimit. (RVB, Takimi me Dekanin, Takim me Stafin Akademik, Lista e pedagogëve këshillues/kujdestarë Evidencë analizuese për përbushjen e kerkesave)
---	--

Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht

Standardi II.3

Programet e studimit të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe të organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Administrimi i programit të studimit në “Arkitekturë Peisazhi” nga d.HAP mbështetet në Rregulloren e Studimeve të UBT, Rregulloren e Programit të Studimit “Arkitekturë Peisazhi, kurrikulën dhe plani mësimor. Ky dokumentacion bazë, i mbështetur në ligjin për arsimin e lartë dhe VKM 41, përcakton strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit “Master Profesional në Arkitekturë Peisazhi”. Këtu përfshihet edhe rregullimi i kriterëve të përgjithshme dhe specifike për pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve. (RVB, Takimi me Dekanin, Takim me Stafin Akademik, Rregulloret përkatëse)
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Programit i studimit “Master Profesional në Arkitekturë Peisazhi” është i organizuar në 15 module, plus praktikë profesionale. Ngarkesa në kredite e çdonjërit nga modulet merr në konsideratë volumin e punës mësimore për arritjen e rezultateve të pritshme mësimore. (RVB, Takimi me Dekanin, Takim me Stafin Akademik, Syllabuset, Ngarkesa mësimore për secilin staf akademik, Rregulloret përkatëse)
Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Departamenti ka të arshivuar të gjithë programet lëndore (silabuset) e moduleve që zhvillohen në programin e studimit “Master Profesional në Arkitekturë Peisazhi”. Ato janë përditësuar sipas formatit të VKM 41 dhe pasqyrojnë të gjithë komponentët mësimorë. (RVB, Takimi me Dekanin, Takim me Stafin Akademik, Syllabuset)
Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në	Programi i studimit “Arkitekturë Peisazhi” ka dosjen e tij pranë d.HAP ku ndodhet plani mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për

auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj. (RVB, Takimi me Dekanin, Takim me Stafin Akademik, Lista e pedagogëve, Syllabuset)			
Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Përmbajtja e planit mësimor u bëhet e njohur studentëve sapo fillojnë studimet në programin Hortikulturë. Syllabuset e moduleve mësimore u bëhen të njohur studentëve nga pedagogët në fillim të çdo moduli mësimor, ato janë të përgatitura në shqip dhe anglisht, janë të miratuara dhe depoziuara në Departament. Syllabuset ju vihen në dispozicion studenteve edhe në faqen e internetit të çdo pedagogu (RVB, Takimi me Dekanin, Takim me Stafin Akademik, Takimi me Studentët, Syllabuset)			
Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikatat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Në dosjen e programit të studimit ndodhen programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikatat, seminarat apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. (RVB, Takimi me Dekanin, Takim me Stafin Akademik, Syllabuset)			
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Përmbajtja e programeve të studimit është në përditësim të vazhdueshëm. Përditësimet miratohen në fillim të çdo viti akademik kur pedagogët kërkojnë të përmirësojnë pjesë të programit apo referencave. Syllabusi miratohet nga përgjegjësi i departamentit dhe zëvendëson silabusin e mëparshëm në dosje. (RVB, Takimi me Dekanin, Takim me Stafin Akademik, Syllabuset)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënës, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Sipas nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe rregulloreve të brendshme. Në zbatim të VKM 41 programi i studimit "Master Profesional në Arkitekturë Peisazhi" ka 120 kredite. (RVB, Takimi me Dekanin, Takim me Stafin Akademik, Rregulloret përkatëse, VKM)

<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Programi i studimit “Master Profesional në Arkitekturë Peisazhi” përmban module karakterizuese dhe integruese që formojnë shprehitë bazë të specialiteteve, siç janë ‘Bazat e Arkitekturës së Peisazhit’, ‘Kopshtaria Urbane’, ‘Menaxhimi i Qëndrueshëm dhe Mirëmbajtja e Peisazhit’, ‘Grafika dhe Metodrat Kompjuterike në Projektimin e Peisazhit’, ‘Lulëtaria e Peisazhit’, ‘Shkurret dhe Drurët Dekorative’, ‘Tapetet e Gjebra’ etj. (RVB, Takimi me Dekanin, Takim me Stafin Akademik, Rregulloret përkatëse, Kuadri i përgjithshëm formues)</p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Plani mësimor është i ekuilibruar ndërmjet orëve teorike dhe praktike. Kurrikula e programit të studimit “Arkitekturë Peisazhi” është hartuar në përputhje me nevojat e specialiteteve dhe e përafuar me programe homologe jashtë vendit. Personeli akademik bën përpjekje për përditësimin e informacionit gjë që reflektohet edhe në syllabuse. (RVB, Takimi me Dekanin, Takim me Stafin Akademik, CV, Kualifikimet, Syllabuset)</p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Struktura e programit “Master Profesional në Arkitekturë Peisazhi”, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë janë në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. (RVB, Takimi me Dekanin, Takim me Stafin Akademik, Programet te ngjashme)</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Modulet janë të shpërndara në mënyrë të ekuilibruar midis veprimtarive formuese. Kështu në kategorinë e lëndëve bazë që përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme janë parashikuar 3 module që përbëjnë 15% të krediteve. Kategoria e lëndëve karakterizuese, që lidhet me veçoritë e programit të studimit dhe i japin studentëve aftësitë e nevojshme profesionale, përbëjnë 35% të krediteve. Kategoria e lëndëve karakterizuese plotësohet me modulet ndërdisiplinore që zënë 15% të krediteve. Lëndët plotësuese përfshijnë dhe praktikën profesionale. (RVB, Takimi me Dekanin, Takim me Stafin Akademik, Syllabuset, Raport mbështetës në Shtojcën 1 të VKM 41 dt. 24.1.2018).</p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme dhe miratohen në njësinë bazë në fillim të çdo viti akademik duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit. (RVB, Takimi me Dekanin, Takim me Stafin Akademik, Syllabuset)</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Programi i studimit “Master Profesional në Arkitekturë Peisazhi” siguron afërsi dhe kompetenca që përfshijnë: Të punuarit në ekipe për planifikimin e sistemeve të hapësirave publike, planifikimin e zonave rekreative dhe turistike</p>

	dhe për ruajtjen e natyrës; punë individuale ose në grup për projektimin dhe ndërtimin e kopshteve, hapësirave të gjelbërta dhe zonave rekreative, parqeve, objekteve dhe paisjeve të kopshteve e parqeve; Organizimin e prodhimit të fidanave të pemëve dekorative, shkurreve dhe luleve për zbulimin e peisazhit; Organizimin e mirëmbajtjes, kujdesit dhe mbrojtjes së gjelbërimit; Mbrojtjen e natyrës dhe të mjedisit. (RVB, Takimi me Dekanin, Takim me Stafin Akademik, Syllabuset)			
Kriteri 8. Organizimi i programit të studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Programi i studimit “Master Profesional në Arkitekturë Peisazhi” siguron aftësi dhe kompetenca që përfshijnë punë individuale për projektimin dhe ndërtimin e kopshteve, hapësirave të gjelbërta dhe zonave rekreative, parqeve, objekteve dhe paisjeve të kopshteve e parqeve; Organizimin e prodhimit të fidanave të pemëve dekorative, shkurreve dhe luleve për zbulimin e peisazhit; Organizimin e mirëmbajtjes, kujdesit dhe mbrojtjes së gjelbërimit; Mbrojtjen e natyrës dhe të mjedisit. (RVB, Takimi me Dekanin, Takim me Stafin Akademik, Syllabuset)			
Kriteri 9. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Përmbajtja e programit të studimit “Master Profesional në Arkitekturë Peisazhi” mundëson pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës në drejtoritë e planifikimit të qyteteve, organizatat e planifikimit urban, zyrat e projekteve, kompanitë e ndërtimit, zyrat e shërbimeve publike për mirëmbajtjen e gjelbërimit, etj. (RVB, Takimi me Dekanin, Takim me Stafin Akademik, Syllabuset, Programet mësimore)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien e këtij programi ka kompetencë dhe përvojë të gjatë mësimdhënie por edhe angazhim në këshillim tekniko-profesional për donatorë, biznese private apo agjenci publike. (RVB, Takimi me Dekanin, Takim me Stafin Akademik, Syllabuset, Programet mësimore, CV)
Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të	Kualifikimet dhe përvoja didaktike e lektorëve është në përputhje me modulën që mbulon në këtë program studimor, duke respektuar bazën ligjore në fuqi

kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	dhe aktet e brendshme rregullatore të tij. Edhe personeli ndihmës akademik i angazhuar është gjithashtu me përvojë të gjatë punë. (RVB, Takimi me Dekanin, Takim me Stafin Akademik, CV)			
Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.	Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit “Master Profesional në Arkitekturë Peisazhi” janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij. (RVB, Takimi me Dekanin, Takim me Stafin Akademik, Syllabuset, Programet mësimore, CV)			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për udhëzimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	UBT, FBM dhe dHAP, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vënë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për udhëzimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. (RVB, Takimi me Dekanin, Takim me Stafin Akademik, Marrëveshjet)			
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësmësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Programi i studimit “Master Profesional në Arkitekturë Peisazhi” i zhvillon një pjesë të punëve praktike në natyrë, në laboratorët fushorë të kampusit të UBT. (RVB, Takimi me Dekanin, Takim me Stafin Akademik)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6	
Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe realizimin me sukses të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Programi studimit “Master Profesional në Arkitekturë Peisazhi” gjatë periudhës 6 vjeçare të ekzistencës së tij ka pësuar një sërë përmirësimesh. Këto përmirësime kanë ardhur si rezultat i konsultimeve me partnerët e programit dhe kanë bërë që programi të ketë një përshtatje më të mirë me tregun e punës. Duke qene se është nje program relativisht i ri përmirësimet në kurrikul kanë ardhur si konsultim dhe analiza me partnerët dhe pedagogët për të bërë një përshtatje më të mirë me tregun e punës

<p>Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimit të programit të studimit, edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>UBT organizon dy herë në vit anketim të studentëve ku merren sugjerimet e tyre lidhur me programet e studimit që ata ndjekin. Përmirësimet e përmendura më sipër kanë synuar të pasqyrojnë edhe sygjerimet e studentëve. Në përbërje të grupit të punës që përgatiti këtë rapor vetëvlerësimi është edhe një përfaqësuese e studentëve. (RVB, Takimi me Dekanin, Takim me Stafin Akademik, Takimi me Studentët)</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të studimit.</p>	<p>Pranë departamentit është përgatitur një databazë e studentëve që janë diplomuar në programin e studimit “Master Profesional në Arkitekturë Peisazhi”. Një pjesë e tyre kanë kontribuar në projektet e peisazhit të kampusit të UBT. Ky komunikim ndihmon edhe në marrjen e opinioneve të tyre për përshtatjen më të mirë të programit të studimit me tregun e punës. Ketu mund te vendosesh si rekomandim që departamenti duhet të bëjë anketa me studentët e diplomuar për të marrë nje feedback për përshtatjen e programit me tregun e punës</p>			
<p>Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj, institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale dhe zhvillimi.</p>	<p>UBT ka një sërë marrëveshesh bashkëpunimi me institucione private dhe publike. Si rezultat i këtij bashkëpunimi departamenti mendon të përgatisë një program studimi një vjeçar në fushën e kopshtarisë. (Takim me dekanin)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	UBT ka hartuar dhe miratuar udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve (Statuti, Rregullore e Studimeve Universitare “Udhëzuesin për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies, Rregullore e Programit të Studimit “Arkitekturë Peisazhi”)
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik (Statuti, pyetësoret për Vlerësimin e Procesit Mësimor, RVB, Takimi me Dekanin, Takim me Stafin Akademik, Takimi me Studentët, dy anketat që departamenti tha që zhvillohen në fund të çdo semestri per çdo lëndë)
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	Anketimet e studentëve realizohen periodikisht në përfundim të çdo semestri akademik. Rezultatet e tyre bëhen publike pas përfundimit të procesit. (Statuti, Pyetësoret për Vlerësimin e Procesit Mësimor, RVB, Takimi me Dekanin, Takim me Stafin Akademik)
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Në nivelin e njësisë kryesore dhe bazë, strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë janë përgjegjësit e grupeve mësimore kërkimore (GMK), zv/dekani për mësimin dhe Dega e Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional (DZHKKVI) dhe Dega e Informacionit dhe Transferimit të Njohurive (DITNJ). UBT realizon analiza vjetore të procesit mësimor duke identifikuar problemet që dalin dhe duke marrë masat e duhura për përmirësimin e situatës. (Rregullorja e Degës së Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional dhe Dega e Informacionit dhe Transferimit të Njohurive, Raportet e analizës mësimore për vitet akademike; 2017-2018, 2016-2017, 2015-2016, 2014-2015, 2013-2014 Pyetësoret për Vlerësimin e Procesit Mësimor, RVB, Takimi me Dekanin, Takim me Stafin Akademik, Takimi me Studentët)
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Një pjesë e mirë e personelit ka patur shkëmbime në kuadër të programeve Tempus dhe Erasmus+ duke i mundësuar të huazojë dhe përdorë teknika inovative që aplikohen në universitetet më të mira të Evropës dhe SHBA. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Informacioni mbi shkëmbimet në kuadër të ERASMUS+ të personelit akademik, Anketa)

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Format e mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit “Master Profesional në Arkitekturë Peisazhi” janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Syllabuset)
Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t’i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.	Personeli akademik njeh dhe respekton diversitetin e karaktereve dhe interesave individuale të studentëve dhe përshtat metodat e mësimdhënies dhe mësimnxënies me këto veçori. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Syllabuset, Takimi me Studentët)
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni duhet të mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të nxënies, objektivat formuese dhe kërkesat e punëdhënësve.	Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike Shumica e moduleve përfshijnë seminarë dhe detyra kursi ose projekt-kursi. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Syllabuset, Takimi me Studentët)
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	Personeli akademik në mësimdhënie është anagazhuar në programet e shkëmbimeve Erasmus+, përvoja të tjera mësimdhënie jashtë vendit (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Syllabuset, Takimi me Studentët)
Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Institucioni vlerëson realizimin e praktikave mësimore pranë bashkisë Tiranë dhe bizneseve të ndryshme. UBT mbështet në mënyrë të vazhdueshme dhe me forma të shumëllojshme (trainime, mësim të hapura, promovimi i praktikave të mira në mësimdhënie) kualifikimin e mëtijshëm të stafit pedagogjik dhe nxit shfrytëzimin e metodave inovative në përputhje me nevojat specifike të punëdhënësve në këtë sektorin (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Syllabuset, Takimi me Studentët)

<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p>	<p>Cilësia e mësimit është objekt konstant i analizave vjetore të mësimit nga stafi akademik, por edhe i vlerësimit të studentëve nëpërmjet anketimit periodik të tyre. Rezultatet e anketimit i nënshtrohen analizës dhe si individualisht, ashtu edhe në nivel departamenti merren masa për të reflektuar mendimet dhe sugjerimet e tyre për përmirësimin e mësimit/mësimnxënies. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Syllabuset, Takimi me Studentët, Statuti i UBT, Pyetësor për Vlerësimin e Procesit Mësimor)</p>			
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimit inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësuesi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Procesi i mësimit dhe mësimnxënies është interaktiv dhe stimulon punën e pavarur të studentëve. Këtij qëllimi i shërben rritja e peshës së detyrave dhe projekteve të kursit. Përgatitja e detyrave/projekteve të kursit është punë e pavarur e studentëve, monitorohet e mbështetet nga personeli akademik gjatë të gjithë kohës së realizimit të saj (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Syllabuset, Takimi me Studentët, Statuti i UBT, Pyetësor për Vlerësimin e Procesit Mësimor)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimit, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Programi “Master Profesional në Arkitekturë Peisazhi” realizohet në disa godina të Kampusit të UBT në varësi të laboratorëve. Një pjesë e mirë e ambienteve janë të rikonstruara dhe cilësore. Është e nevojshme shtimi dhe përmirësimi i infrastrukturës mësimdhënëse dhe laboratoreve (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Studentët, Vizita në institucion)</p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor dhe praktikave.</p>	<p>Infrastruktura në dispozicion të mësimit është ndërtuar në funksion të mësimit dhe janë funksionale. Janë bërë përpjekje maksimale brenda buxhetit, për sigurimin e logjistikës së nevojshme. Është e nevojshme shtimi dhe përmirësimi i infrastruktures mësimdhënëse dhe laboratoreve (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Studentët, Vizita në institucion)</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor. Është e nevojshme shtimi dhe përmirësimi i infrastrukturës mësimdhënëse dhe laboratoreve (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Studentët, Vizita në institucion)</p>

<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Për të gjithë modulet e programit mësimor “Master Profesional në Arkitekturë Peisazhi” ekziston literatura bazë në gjuhën shqipe, përgatitur nga pedagogët përkatës. Një pjesë e mirë e lëndëve të formimit profesional mbështeten me tekste mësimore të miratuara në departament. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Studentët, Vizita në institucion)</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Në mjediset e kampusit (në qendër të tij), funksionon Biblioteka Shkencore “Mentor Përmeti”. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Studentët, Vizita në institucion)</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Në dispozicion të stafit akademik dhe studentëve të UBT ka një librari digjitale (TEEAL- The Essential Electronic Agricultural Library) që mundëson aksesimin on line të rreth 450 revistave shkencore të bujqësisë dhe shkencave të përafërta Libraria është e aksesueshme nga të gjithë studentët dhe pedagogët nëpërmjet laptopëve, tabletave, apo telefonave smart. Lidhur me Programin “Master Profesional në Arkitekturë Peisazhi” është e nevojshme përdorimi i këtij shërbimi i librave për këtë program. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Studentët, Vizita në institucion)</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Në dispozicion të studentëve të Programit “Master Profesional në Arkitekturë Peisazhi” është një studio e arkitekturës së peisazhit e paisur me kompjutera dhe programe projektimi. Ndërkohë për disa prej moduleve mund të përdoret edhe laboratorit Shkencor i Hortikulturës dhe të tjera laboratorë në Universitetin Bujqësor të Tiranës të cilët janë të hapur për realizimin e orëve laboratorike dhe realizimin e punimeve të thjeshta shkencore nga ana e studentëve. Është e nevojshme shtimi dhe përmirësimi i infrastruktures së mësimdhënies dhe laboratoreve (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Studentët, Vizita në institucion)</p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personelin akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Për momentin nuk ka platforma on-line (e-learning). Po bëhen përpjekje, në kuadër të programit Erasmus+ për ngritje kapacitetesh që të futen në përdorim këto platforma. Është e nevojshme prezantimi i këtij shërbimi (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Studentët, Vizita në institucion)</p>
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik. Personeli akademik ka hapësirë vetjake të dedikuar e cila mund të arrihet edhe nga studentët sipas lëndëve që zhvillojnë. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Studentët, Vizita në institucion)</p>
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Studentët në programin “Master Profesional në Arkitekturë Peisazhi” në përgjithësi realizojnë mbrojtje diploma me punime individuale të fokusuar në realizimin e projekteve të peisazhit. Personeli akademik orienton</p>

	studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet zhvillimin e tyre (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me Studentët,)			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	Në institucion ekzistojnë struktura që ndihmojnë dhe monitorojnë procesin mësimor. Në nivel institucioni funksion “Sektori i zhvillimit të kurrikulave dhe vlerësimit institucional” në kuadër të të cilit paralelisht me “Zyrën e studimeve dhe studentëve” dhe “Zyrën e mësimit dhe kurrikulave” funksionon edhe “Zyra e sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit institucional”. Në nivel fakulteti, njëri ngë zëvendësdekanët është përgjegjës për ecurinë e procesit mësimor dhe garantimin e cilësisë së tij. (Statuti i UBT, Struktura Organizative, Kodi i cilësisë së arsimit të lartë. VKM, nr. 531, dt. 11.09.2018, RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me perfaqësues te ketyre Strukturave)
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Në nivel institucional, cilësia e mësimdhënies promovohet dhe monitorohet nga “Komisioni i përhershëm i sigurimit të cilësisë, programeve të studimit dhe kërkimit shkencor”, i cili është përgjegjës për koordinimin e procedurave të vlerësimit të njësive akademike të brendshme dhe të jashtme, kërkimeve shkencore dhe vetë universitetit. Komisionet mbikqyrin dhe implementojnë rregulloret, politikat, programet, proceset akademike dhe jo akademike dhe sigurojnë përputhjen me kuadrin ligjor që siguron cilësi (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me perfaqësues te ketyre Strukturave, Manuali i cilësisë)
Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.	Departamenti i Hortikulturës dhe Arkitekturës së Peisazhit është përgjegjës i kryesor për cilësinë e mësimdhënies në Programin e studimit të ciklit të dytë “Master Profesional në Arkitekturë Peisazhi”. Departamenti monitoron rregullisht procesin e mësimdhënies/mësimnxënies dhe atë të vlerësimit të studentëve dhe analizon periodikisht situatën (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me perfaqësues te Strukturave)
Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Departamenti i Hortikulturës dhe Arkitekturës së peisazhit i kushton rëndësi përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies/mësimnxënies edhe nëpërmjet inkurajimit të aktivitetit shkencor të stafit të vet akademik dhe përfshirjes së studentëve në projekte kërkimi në fushën e Arkitekturës së Peisazhit. Shfrytëzimi i pjesshëm i të dhënëve eksperimentale që përftohen gjatë

	realizimit të projekteve të ndryshme të kërkimit në praktikat mësimore dhe realizimin e detyrave të kursit të studentëve të hortikulturës është një nga metodat më të suksesshme të mësimdhënies/mësimnxënies (RVB, Takimi me Dekanin, Lista e projekteve të kërkimit në Departamentin)
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	Performanca individuale vjetore e stafit akademik monitorohet e vlerësohet rregullisht nëpërmjet plotësimit të formularëve të hartuar për këtë qëllim. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Pyetësori për Vlerësimin e Performancës Akademike)
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik i Departamentit të Hortikulturës dhe Arkitekturës së Peisazhit është i angazhuar në disa projekte dhe studime. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Ndihtmes)
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik i Departamentit të Hortikulturës dhe Arkitekturës së Peisazhit i angazhuar në projekte dhe studime raporton në analizat e punës mësimore shkencore për rezultatet dhe metodat e reja të përdorura për pasurimin e procesi të mësimdhënies. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik dhe Ndihtmes)
Kriteri 8. Institucioni në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.	Departamenti i Hortikulturës dhe Arkitekturës së Peisazhit herë pas here angazhon në procesin e mësimdhënies profesionistë të fushës së gjelbërimit. Në këtë proces pjesëmarrje, këta individë japin edhe sugjerime për përmirësimin e mësimdhënies (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Ndihtmes)
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet
	Përmbushet pjesërisht
	Përmbushet kryesisht
	Përmbushet plotësisht
	X

Standardi III.5	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Rregulloret përcaktojnë qartësisht sistemin e vlerësimit, format e vlerësimit dhe të kontrollit të dijeve, kushtet që duhet të plotësojnë studentët për të hyrë në provim, mënyrën e organizimit të provimeve, shpalljen e rezultateve dhe procedurën e ankimimit të studentëve në rast të pakënaqësive për rezultatet e provimit (RVB, Statuti, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me studentët, Rregulloret përkatëse)
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive	Studentët informohen në detaje për sistemin e vlerësimit, format e vlerësimit dhe të kontrollit të dijeve, kushtet që duhet të plotësojnë studentët për të hyrë

profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	në provim, mënyrën e organizimit të provimeve, shpalljen e rezultateve dhe procedurën e ankimimit të studentëve në rast të pakënaqësive për rezultatet e provimit sidomos për mënyrën e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive në fillim të çdo moduli mësimor. (RVB, Statuti, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me studentët, Syllabuset).			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma të shumëllojshme përfshirë organizimin e seminareve, detyrave të ndërmjetme, ushtrimeve dhe punëve laboratorike, mbrojtjen e detyrave dhe projekteve të kursit, etj. (RVB, Statuti, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me studentët, Syllabuset).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	Vlerësimi i studentit ndahet në dy pjesë: vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuar në programin e modulit (40%), si dhe vlerësimi përfundimtar (60%). Përcaktimi i raporteve mes vlerësimit të vazhduar gjatë vitit dhe vlerësimit përfundimtar bëhet nga pedagogu/pedagogët në programin e modulit dhe ju bëhet e ditur studentëve me fillimin e modulit mësimor. (RVB, Statuti, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me studentët, Syllabuset).
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Pikët e vlerësimit gjatë vitit hidhen në sistemin Esse3 dhe historiku i tyre ruhet nga sistemi për tu konsideruar nga pedagogu edhe për sezonet e tjera. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me studentët, Syllabuset, vizite në sekretarinate mësimore).
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Marrja e studentëve në provim bëhet nga komisioni i provimit që përcaktohet nga Përgjegjësi i Departamentit. Në përbërje të komisioneve janë minimalisht dy antarë. (RVB, Statuti, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik).
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime. Procesi i provimit me shkrim monitorohet me kujdes nga të paktën dy anëtarë të departamentit. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik)
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i	Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale sidomos gjatë procesi mësimor shoqërohet me komente/ feedback dhe lidhet me këshilla mbi

nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik)			
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Departamenti i Hortikulturës dhe Arkitekturës së Peisazhit nuk ka të instaluar ndonjë sistem vlerësimi i cili do të mund të realizonte një vlerësim efektiv dhe objektiv për plagjiaturën. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik)			
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Rezultatet e provimit hidhen në sistem nga komisioni i provimit brenda dy ditëve kur provimi është me gojë dhe brenda 8 ditëve kalendarike nga data e kryerjes së provimit kur provimi është me shkrim ose me shkrim dhe gojë. Pas shpalljes së rezultateve, studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi nga ana e tij, ose të kundërshtojë rezultatin e marrë brenda dy ditëve (48 orë). Komisioni i provimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuar të studentit me tezën e zgjidhur. Mbas këtij afati, nota konsiderohet përfundimtare dhe komisioni ka detyrimin të bëjë mbylljen përfundimtare të procesverbalit (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik)			
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Studenti ka të drejtë të ankimohet në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat proceduriale gjatë zhvillimit të provimit ose nuk është dakord me vlerësimin e bërë. (RVB, Statuti, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me Studentët)			
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Ankesa bëhet me shkrim brenda ditës së zhvillimit të provimit, ose brenda 24 orëve pas kontestimit të rezultatit dhe i drejtohet dekanit të fakultetit, i cili përcakton nëse ankesa e studentit është e drejtë apo jo dhe merr vendimin përkatës. Kur ankesa është e drejtë, Dekani e shpall të pavlefshëm rezultatin e vlerësimit për të cilin studenti është ankuar dhe vendos në bashkëpunim me përgjegjësin e Departamentit, që studenti të rijapë provimin, me një komision me anëtarë të tjerë, në një datë tjetër brenda sezonit, ose jashtë tij, por jo më vonë se 5 ditë nga përfundimi i sezonit përkatës të provimeve. Procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës, si dhe vendimi i marrë regjistrohen në regjistrin e ankesave të studentëve që mbahet në dekanat. RVB, Statuti, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Programi është ndërtuar që të ofrojë studentëve një mënyrë të menduari krijues, kritik dhe sistematik dhe njohuri në shkencat teorike bazë, formim të gjerë profesional dhe njohuri të thelluara në arkitekturën e peisazhit. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me Studentët)</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive në fushën IT dhe programet ACAD etj. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me Studentët).</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me Studentët, Syllabuset)</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.</p>	<p>Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik bën një përmbledhje mbi çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe për mënyrën e organizimit të testit përfundimtar. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me Studentët)</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Në përpjekje për të rritur interesin e studentëve për arkitekturën e peisazhit si profesion i cili ndërthur shkencën dhe artin, personeli akademik i kushton vëmendje përfshirjes në leksione të arritjeve të personaliteteve të shquara dhe perspektivave të zhvillimit të arkitekturës së peisazhit në prodhimin komercial, përfshirë sistemet moderne të vlerësimit të peisazhit, hortikulturën urbane dhe gjelbërimin vertikal etj. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me Studentët)</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Lektorët nxisin imagjinatën dhe inkurajojnë zhvillimin e aftësive krijuese të studentëve. Studentëve u kërkohet që njohuritë e përfuara në leksione të konkretizojnë nëpërmjet detyrave të kursit, punëve të thjeshta eksperimentale në laborator dhe praktikave mësimore dhe profesionale. Në përfundim të praktikës mësimore studentëve ju kërkohet të prezantojnë në mënyrë krijuese dijet e përfuara dhe propozimet e tyre për përmirësimin e mundshëm Kërkohet pjesëmarrje me e madhe të studenteve në laboratore si dhe shtimi dhe përmirësimi i këtyre laboratoreve (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me Studentët)</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Shumica e detyrave të kursit janë të konceptuara me grupe punë. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara. Kërkohet përmirësimi i punës për propozime konkrete (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me Studentët)</p>

Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.	Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët por burimet financiare për ti mbështetur ato financiarisht janë të kufizuara (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me Studentët)			
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët por burimet financiare për ti mbështetur ato financiarisht janë të kufizuara. Kerkohet mbështetje financiare per studenete. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me Studentët)			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Institucioni ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me partner publik dhe privat. Kjo i krijon mundësi personelit akademik që të ndërthurë format e mësimdhënies me to për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve, Kerkohet te rritet mobiliteti i studenteve(RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me Studentët)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.8				
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfitimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizmin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfitimit të njohurive, vazhdojnë perpjekjet që te garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizmin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me Studentët, vizita në institucion)			
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Institucioni punon që te garantoje praktika mësimore profesionale te plota dhe te pergjegjshme per studentët (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me Studentët, vizita në institucion)			
Kriteri 3. Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Praktikat profesionale ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme, (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me Studentët, vizita në institucion)			
	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardit			X	
-------------------------------------	--	--	---	--

Standardi III.9	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Diplomimi i studentëve të programit të ciklit të dytë Master Profesional është i mirërregulluar nga pikëpamja formale në “Rregulloren e Studimeve Universitare” (KreuXII-Diplomimi). Diplomimi realizohet nëpërmjet mbrojtjes së një punimi diplome ose provimit të formimit, programi i të cilit ndërtohet në përputhje me kurrikulat mësimore të programit të studimit. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me Studentët)
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Në funksion të provimit të formimit hartohet një program i vecantë, i cili bëhet publik shumë kohë përpara afatit të përcaktuar të provimit. Programi ka për qëllim të testojë formimin e përgjithshëm dhe atë specifik në lidhje me arkitekturën e peisazhit si profesion. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me Studentët, Programi i provimit të formimit MP Arkitekturë Peisazhi)
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Provimi i formimit mbrohet përpara një komisioni të përbërë nga 5 antarë dhe që përfaqësojnë fushat kryesore të studimit në arkitekturë peisazhi. Vlerësimi bëhet me notë, menjëherë pas përfundimit të provimit. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me Studentët)
Kriteri 4. Personeli akademik orientojnë dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të studimit/diplomave.	Studentëve u ofrohet asistencë e gjerë nga stafi akademik për sqarimin dhe saktësimin e detajeve të programit, apo u ofrohen konsultime dhe ju vihen në dispozicion materiale shtesë në funksion të përgatitjes së tyre për temën e diplomës. Ndërkohë për realizimin e punimeve të diplomës çdo student zgjedh një pedagog si udhëheqës shkencor të punimit të tij. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me Studentët)
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Institucioni asiston për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e tij apo edhe jashtë sipas temave dhe fushës së studimit. Sidoqoftë në rastet kur punimi nuk është pjesë e punimeve të stafit akademik, kjo mbështetje është e kufizuar (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me Studentët)
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me Studentët)

<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Vlerësimi i studentit për provimin ose mbrojtjen e diplomës bëhet me notë, menjëherë pas përfundimit të provimit. Nota është mesatarja e vlerësimit që ka dhënë çdo anëtar i komisionit. Nota hidhet në sistem dhe procesverbali firmoset nga të gjithë anëtarët e Jurisë, si dhe nga personat e tjerë përgjegjës. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me Studentët)</p>			
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Në përfundim të programit të studimit, studenti pajiset me diplomën përkatëse Elementët përbërës, forma e diplomës dhe procedurat për regjistrimin përcaktohen nga ministria përgjegjëse për arsimin. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me Studentët, Kopje e diplomës së përfundimit të studimeve MP Arkitekturë Pezazhi, Kopje e suplementit të diplomës)</p>			
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>UBT dokumenton tërheqjen e diplomës dhe suplementit të diplomës prej secilit student që ka përfunduar me sukses detyrimet akademike dhe ato të tjera institucionale. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me Studentët, Takimi me sekretarë mësimore)</p>			
<p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.</p>	<p>Regjistri i lëshimit të diplomave depozitohet në arkivat e shtetit, sipas kuadrit ligjor në fuqi për arkivat, ndërsa kopja e njëzuar me origjinalin ruhet për një kohë të pacaktuar. Paralelisht me diplomën dhe aneksin e saj, studentëve ju vihet në dispozicion një kopje e plotë zyrtare e programit të studimit në programin e ciklit të dytë "Master Profesional në Arkitekturë Peisazhi". (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me Studentët)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>
--	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	---

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1				
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Personeli akademik me kohë të plotë përbën 75% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimit MP në Arkitekturë Peisazhi. Nga këta 50% janë me kohë të plotë në departamentin e Hortikulturës dhe Arkitekturës së Peisazhit, 12,5% janë pedagogë të Departamenteve të tjera të Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit ku bënë pjesë edhe departamenti i Hortikulturës dhe Arkitekturës së Peisazhit, 12,5% janë personel akademik të Universiteti Bujqësor, por të fakulteteve të tjera dhe 25% janë personel akademik nga Univrsitete të tjera, kryesisht UPT, fakulteti i Arkitekturës. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik)			
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Politika e punësimit dhe të rekrutimit të burimeve njerëzore ndiqet nga departamenti Fakulteti dhe Universteteti. Procedurat e perzgjedhjes janë të hapura, me konkurs dhe me objektiv përzgjedhjen e personave të kualifikuar që zotërojnë grada e tituj shkencorë. Rekrutimi bëhet sipas rregullore së posaçme të rekrutimit të UBT. Kjo procedurë administrohet nga Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Pagave. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takim me Stafin e Dr Burimeve Njerezore, Rregullorja e Rekrutimit, Rregullorja e Zyrës së Burimeve Njerëzore Dokumentacioni për rekrutimin)			
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	Institucioni ka zbatuar ligjin 80/2015 në rekrutimin e punonjësve akademikë. Senati Akademik i UBT ka vendosur kritere bazë për rekrutimin e personelit, të cilat janë bërë publike në çdo konkurs. Nuk jepet ndonjje informacion për metodat për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takim me Stafin e Dr Burimeve Njerezore)			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	Institucioni i arsimit të lartë dëshmon një angazhim të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë. Kerkohet angazhim nga te gjitha strukturat e IAL per te realizuar këtë objektiv (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takim me Stafin e Dr Burimeve Njerezore)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2				
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efikente dhe efektive				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	FBM dhe veçanërisht d.HAP ka një staf të plotë që i përkasin brezave të ndryshëm dhe si i tillë është një mjedis stimulues për shkëmbimin e përvojës në mësimdhënie. Kerkohet zhvillimi i kapaciteteve për llojin e programit Master në Arkitekture Peisazhi (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik)			
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	UBT-ja është angazhuar në politikat integruese të personelit të vet, duke i dhënë mundësi për trajnime dhe kualifikime të ndryshme në përputhje me fushat e studimit. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik)			
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	Universiteti ka inkurajuar promovimin e stafit akademik në universitetet perendimore. Duhet shfrytëzuar të gjitha projektet ndërkombëtare që janë në veprim për kualifikimin dhe trainimin e stafit, sidomos stafit të ri, për kryerjen e doktoraturave të plota, apo mobilitete në kuadër të doktoratës në institucionet partnere lidhur me këtë program. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik)			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	Ne programin “Arkitekturë Peisazhi” është në dispozicion një personel akademik i kualifikuar, i cili veç përvojës së gjatë në mësimdhënie, ka edhe një aktivitet kërkimor dhe specializime në fushën që lidhet me modulet që japin mësim. Duke qenë një fushë unike, kerkohet të zhvillohet cilesia e lektoreve lidhur me fushat që ofron ky master. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Të dhëna për kualifikimet).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	


Standardi IV.3				
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Studentët e programit “Arkitekturë Peisazhi” kanë në dispozicion një infrastrukturë fizike, didaktike dhe logjistike për të realizuar programin mësimor. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me studentët, Vizita në institucion)			

<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Një pjesë e mirë e moduleve përmbajnë orë laboratorike të cilat zhvillohen në laboratorë të posaçëm dhe të pajisur. Pjesa tjetër e moduleve realizohet në formën e praktikave mësimore që realizohen në kabinete mësimore të posaçme dhe në mjedise didaktike fushore brenda kampusit.. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me studentët, Vizita në institucion)</p>			
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Një pjesë e mirë e moduleve përmbajnë orë laboratorike të cilat zhvillohen në laboratorë të posaçëm dhe të pajisur. Pjesa tjetër e moduleve realizohet në formën e praktikave mësimore që realizohen në kabinete mësimore të posaçme dhe në mjedise didaktike fushore brenda kampusit. Kërkohej te shtohen laboratore dhe klasa mësimore në dispozicion te ketij programi. Labororet jane kryesisht te pajisur me aparatura te nevojshme. Gjithashtu edhe Kopshti Botanik per zhvillimin e praktikave (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me studentët, Vizita në institucion)</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.</p>	<p>Programi “Arkitekturë Peisazhi” ka një studio të mirëpajisur të arkitekturës së peisazhit. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me studentët, Vizita në institucion, Planimetria e studio se arkitektures se peisazhit)</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe /ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike</p>	<p>Kapacitetet e UBT dhe marrëveshja e bashkëpunimit me Universitetin Politeknik garantojnë, që mjediset në dispozicion të këtij programi të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me studentët, Vizita në institucion)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.

<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët do të kenë qasje në libraritë on-line të fushës së arkitekturës së peisazhit dhe kopshtarisë. Biblioteka mësimore e institucioinit duhet te shtoje botimet në dispozicion te ketij programi. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me studentët, Vizita në institucion)</p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të</p>	<p>Një pjesë e moduleve në programin “Arkitekturë Peisazhi” është e mbuluar me tekste universitare të cilat gjenden gjithashtu në Bibliotekën e UBT. Biblioteka mësimore e institucioinit duhet te shtoje botimet në dispozicion te</p>



huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	ketij programi. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me studentët, Vizita në institucion)			
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me studentët, Vizita në institucion)			
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Biblioteka qëndron e hapur nga e hënë në të premte 8.00 – 16.00, orararet e saj janë publike dhe funksionon sigurisht përmes kartelave të regjistrimit. Kerkohet përmirësimi i informacionit për këtë program dhe zhfrytëzimi i tij pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me studentët, Vizita në institucion)			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Institucioni po harton në plan për përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me studentët, Vizita në institucion).			
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	Institucioni po harton në plan për përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit Oraret e bibliotekës janë nga mëngjesi deri pasdite në dispozicion të studentëve me orare të përshtatshme. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me studentët, Vizita në institucion, Takimi në bibliotekë).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	I gjithë informacioni për studentët dhe aktivitetin e tyre administrohet nëpërmjet sistemit ESSE3 që përfshin një sekretari elektronik të plotë (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me studentët, Vizita në institucion Manuali për regjistrimin e studentëve)
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrohet informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	UBT administrohet informacionin e plotë të stafit akademik (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me studentët, Vizita në institucion)

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi ESSE3 i referuar më lart, administron gjithashtu dokumentacionin e hartuar nga pedagogu në lidhje me vlerësimin e studentëve. Pjesa tjetër e dokumentacionit janë fletët e ngarkesave dhe regjistrat e pedagogut që janë të sekretuar dhe që fotokopjohen në fund të çdo viti akademik. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me studentët, Vizita në Institucion)</p>			
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Sistemi përdoret njëherazi nga studentët, pedagogët dhe sekretaret dhe ka të integruar edhe sistemin e pagesave me bankë të tarifave dhe pagesave për shërbime. Për çdonjërin nga këta përdorues ka një udhëzues për përdorimin e modulit përkatës. Sistemi ESSE3 siguron akses të dedikuar por njëkohësisht është i mbrojtur nga ndërhyrjet. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me studentët, Vizita në Institucion)</p>			
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Në funksion të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve, pedagogët dhe studentët përdorin masivisht Google Aps. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me studentët, Vizita në Institucion, Manuali i përdorimit të aplikacioneve të Google)</p>			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe</p>	<p>Informacioni për programin e studimit “Hortikulturë” është i publikuar në faqen e internetit të UBT, nënfaqja e departamentit. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me studentët, Vizita në Institucion, Struktura e faqes zyrtare të UBT)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
<p>Standardi IV.6 Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</p>				
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>			
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Hartimi dhe miratimi në total i buxhetit të Universitetit fillon nga njësitë bazë, kryesore dhe ndihmëse të tij. Në këtë fazë, merren parasysh nevojat financiare për mbarëvajtjen e programeve të studimit për një cikël të plotë studimi. Duke qenë se janë disa departamente që kontribuojnë në realizimin e një programi studimi, janë njësitë kryesore që hartojnë dhe miratojnë projekt buxhetin e tyre në nivel departamenti dhe pas miratimit të tij në dekanatin përkatës, e paraqesin atë në Rektorat. Administrata e Universitetit, harton projekt buxhetin e njësisve të tjera ndihmëse dhe së bashku me projekt buxhetet e njësisve kryesore, harton projekt buxhetin e vitit respektiv (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Llogaritja e kostos mesatare për çdo student, Buxhetet e UBT për vitet 2016-2017-2018)</p>			

<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një progra studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologji mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin literaturës e aksesin në bibliotekat on-line detyrimet financiare, grantet vendëse apo huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zë të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Burimet financiare shpërndahen dhe përdoren sipas strukturës së Buxhetit të Shtetit dhe realizohet në dy faza, hartimin dhe miratimin e buxhetit nga granti i pakushtëzuar që akordohet nga MAS dhe buxhetin nga të ardhurat e Universitetit. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Llogaritja e koston mesatare për çdo student, Buxhetet e UBT për vitet 2016-2017-2018)</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Si çdo institucion publik, UBT e bazon gjithë veprimtarinë në respekt të ligjit për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare dhe se çdo vit dorëzon pranë MAS dhe Degës së Thesarit Tiranë Pasqyrat financiare vjetore të çdo viti. UBT i nënshtrohet auditimit financiar që realizohet nga Auditi i Brendshëm dhe nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Llogaritja e koston mesatare për çdo student, Buxhetet e UBT për vitet 2016-2017-2018)</p>			
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Si çdo institucion publik, UBT e bazon gjithë veprimtarinë në respekt të ligjit për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare dhe se çdo vit dorëzon pranë MAS dhe Degës së Thesarit Tiranë Pasqyrat financiare vjetore të çdo viti. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Llogaritja e koston mesatare për çdo student, Buxhetet e UBT për vitet 2016-2017-2018)</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen</p>	<p>Institucioni ka rritur perpjekjet për të garantuar qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Llogaritja e koston mesatare për çdo student, Buxhetet e UBT për vitet 2016-2017-2018)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Procedurat dhe politikat që lidhen me studimet në UBT bazohen tërësisht në dispozitat e Ligjit 80/2015. Rregullorja e Studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional në Arkitekturë Peisazhi” përcakton të drejtën e studimeve në master profesional në arkitekturë peisazhi për studentët e niveleve të ndryshme. Parimet dhe procedurat janë të reflektuara në Rregulloren e Brendshme të FBM-se Po ashtu edhe në rregulloren e Zyrës së Studimeve dhe Studentëve (ZSS) specifikohen rregullat e regjistrimit të studentëve, hartimit të planeve mësimore, struktura e vitit akademik, zhvillimit të provimeve, përgatitjes dhe shpërndarjes së diplomave etj. Përgjegjësi i ZSS kontrollon dhe monitoron në mënyrë të vazhdueshme, zbatimin korrekt të këtyre rregullave. Rregullorja e programit përcakton procedurat e tërheqjes së diplomës sipas kërkesave të ligjit 80/2015.</p> <p>Në varësi të kësaj dege (DITNJ), dhe në varësi të Qendrës së Karrierës dhe Alumni (QKA), është ngritur Zyra e Karrierës së Studentëve (ZKS), e cila realizon aktivitete të informimit, orientimit dhe të pranimit të regjistrimeve të studentëve në ciklin e dytë të studimeve. Studentët informohen për të gjithë ciklin e studimit nga pranimi i tyre deri në diplomim.</p> <p>Në FBM është ngritur ZKS në varësi të saj dhe QKA. ZKS-të është një strukturë e veçantë për pritjen, informimin dhe pranimin e studentëve të rinj. ZKS-ja realizon një komunikim të shpejtë dhe të vazhdueshëm me studentët, që kërkojnë të orientohen dhe informohen studentët rreth nevojave dhe kërkesave të tyre. (RVB, Statuti, Rregulloret përkatëse, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takim me zyrat përkatëse, Rregullore e Zyrës së Studimeve dhe Studenteve)</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>UBT në zbatim të Ligjit 80/2015, neni 74, ndjek procedurat dhe informon palët e interesuara për të lehtësuar aplikimin e sistemit online të ministrisë për maturën shtetërore. Në zbatim të Ligjit 80/2015, neni 74, kriteret e pranimit të studentëve në UBT shpallen me vendim Rektorati, i cili miratohet nga Senati Akademik. Strukturat që ndjekin zbatimin e vendimit janë Zv/Rektori për Mësimin, DZHKVI, ZSS dhe QKA. Bazuar në rregulloren e FBM nuk bëhen diskriminime në bazë gjinie, etnie, origjine apo shtetësie në këto procedura. Programi i studimit mund të ndiqet nga shtetas shqiptarë, shqiptarë etnike jashtë kufijve shtetërore si dhe nga çdo shtetas i huaj, në bazë të kritereve të përcaktuara nga MASR, statuti i UBTs dhe rregullorja e studimeve të FBM-s.</p>

	(RVB, Statuti, Vendim Rektorati, Rregulloret përkatëse, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takim me zyrat përkatëse, Rregullore e Zyrës së Studimeve dhe Studenteve)
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Për studentët që ndjekin programin e studimit Master Profesional "Arkitekture Peisazhi", departamenti në bashkëpunim me FBM, harton kritere dhe procedura të përzgjedhjes së studentëve që janë lehtësisht të kuptueshme dhe që mund të aksesohen lehtësisht nga gjithë të interesuarit. Informacioni për kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit bëhen publike përmes faqes web të UBT në seksionin e veçantë të departamentit si dhe të këtij programi studimi. Publikimi dhe qartësimi me pika shpjeguese siguron që procedurat të jenë transparente, të shkruara thjesht, të kuptueshme dhe të aksesueshme. Sekretaritet mësimor të ZSS-së udhëzojnë dhe sqarojnë të interesuarit nëpërmjet korrespondencës apo sporteleve të shërbimit. Informacion mbi elementët e ndryshëm të ciklit të studimit si kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit gjëndet në arshiven e departamentit dhe në formë elektronike në hapësirën e dedikuar në web të UBT dhe FBM. (RVB, Statuti, Vendim Rektorati, Rregulloret përkatëse, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takim me zyrat përkatëse, Rregullore e Zyrës së Studimeve dhe Studenteve).
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.	Programi "Master Profesional në Arkitekturë Peisazhi" nuk ka kritere të veçanta. Kriteret e pranimit të studentëve në këtë program studimi janë të përcaktuara në Rregulloren e FBM dhe Rregulloren e programit të studimit në "Arkitekturë Peisazhi". Këto kritere publikohen në faqen on-line të website zyrtar të UBT-së, me qëllim që publiku i interesuar ta marrë këtë informacion si dhe nëpërmjet ZKS të FBM (RVB, Statuti, Vendim Rektorati, Rregulloret përkatëse, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takim me zyrat përkatëse, Rregullore e Zyrës së Studimeve dhe Studenteve).
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit	Departamenti kryen takim informues në javën e parë të mësimit ku ofrohet informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij, si materialin promovues (fletëpalosje) me informacion prezantues rreth UBT, programet e studimeve që ofrohen dhe kriteret e regjistrimit. Sektori i IT ka përgjegjësinë të sigurojë mirëmbajtjen dhe funksionimin normal të sistemit ESSE3 e të pasqyrojë çdo informacion të destinuar për t'u publikuar në internet në portalin e UBT-së (RVB, Statuti, Vendim Rektorati, Rregulloret


	përkatëse, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takim me zyrat përkatëse).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Në rregulloren e FBM përcaktohen kriteret e kalimit të studentëve nga një vit akademik në tjetrin, numri i krediteve të nevojshme, nota minimale kaluese etj., publikuar nëpërmjet sistemit të informacionit. Nëpërmjet zyrave përkatëse (ZSS), sistemit të brendshëm menaxhimit të informacionit dhe sekretarisë së departamentit, vë në dispozicion gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me kriteret që duhet të ndiqen e procedurat e zbatuara për përparimin akademik dhe kalimin e studentëve në vitin pasardhës. (RVB, Statuti, Vendim Rektorati, Rregulloret përkatëse, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takim me zyrat përkatëse)
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Studentët informohen në lidhje me procedurat e njohjes së kualifikimeve ose studimeve të pjesshme që ata mund të kenë realizuar në institucione të tjera të Arsimit të Lartë, programe të tjera studimi ose studime të kryera jashtë (rasti i projektit ERASMUS+) ku studentët mund të bëjnë një semestër në një Universitet homolog jashtë vendit). Gjithashtu në programin e studimit pasqyrohet informacioni për kriteret e pranimit të studentëve, rregullat e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve si pjesë e dosjes së programit të studimit. Kriteret e transferimit dhe ekuivalentimit sanksionohen në rregulloren e UBT (RVB, Statuti, Vendim Rektorati, Rregulloret përkatëse, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takim me zyrat përkatëse).
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	FBM, nëpërmjet zyrave përkatëse (ZSS), sistemit të menaxhimit të informacionit dhe sekretarisë së departamentit, informon studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive në programin e studimit. Krite dhe procedurat e vlerësimit të studentëve në programin e studimit përcaktohen mjaft qartë në rregulloren e FBM-s. Sipas saj, format e kontrollit të dijeve janë: testimet ndërmjetëse, mbrojtja e detyrave të kursit, ushtrimeve në laborator, mbrojtja e praktikave profesionale, provimet e kursit, provimet e formimit, mbrojtja e diplomave, etj. (RVB, Statuti, Vendim Rektorati, Rregulloret përkatëse, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takim me zyrat përkatëse, Syllabuset)

<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Gjithashtu, në rregulloren e programit të studimit përcaktohen procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të tyre në programin e studimit të ciklit të dytë “Master Profesional në Arkitekturë Peisazhi” dhe parapërgatit studentët për mënyrat e zhvillimit të provimit përfundimtar për çdo modul (provim me gojë, me shkrim, me gojë dhe me shkrim). (RVB, Statuti, Vendim Rektorati, Rregulloret përkatëse, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik)</p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>Informacioni për kriteret i bëhet i ditur aplikantëve potencialë në fushatat e marketingut të programit të studimit si edhe në materialet online të vendosura në faqen web të UBT. Departamenti që mbulon këtë program studimi, në mënyrë periodike përpara fillimit të vitit akademik, organizon takime të hapura për informimin e studentëve dhe të tjerëve të interesuar në lidhje me programin e studimit në “Arkitekturë Peisazhi”. UBT dhe FBM ofron informacion, materiale promovuese (fletëpalosje) dhe orientim për kandidatët që zgjedhin të vijojnë studimet e tyre pranë UBT duke vënë në dispozicion sekretaritë mësimore, Zyrën e Studimeve dhe Studentëve. Gjithashtu në web aplikantët e të interesuarit gjejnë informacione të rëndësishme si materialin promovues (fletëpalosje) e cila përmban informacion prezantues rreth UBT për programet e studimeve të ciklit të dytë ofrohen pranë UBT. (RVB, Statuti, Vendim Rektorati, Rregulloret përkatëse, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takim me zyrat përkatëse).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.3</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Studentët e programit të studimit “Master Profesional në Arkitekturë Peisazhi” kanë mundësi të informohen në mënyrë të hollësishme përmes dokumentave si rregullorja e programit të studimit, rregullorja e fakultetit dhe në mënyrë të shkurtuar në fletë palosje dhe broshura për strukturën, organizimin dhe programin e studimit, të vendosura në stendën e departamentit/fakultetit si dhe pranë sekretarisë së departamentit. Ky informacion gjëndet në arkivën e departamentit dhe në formë elektronike në hapësirën e dedikuar në web faqen e UBT, FBM, d.HAP. (RVB, Statuti, Rregulloret përkatëse, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takim me zyrat përkatëse)</p>

<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Studentët e programit të studimit të “Master Profesional në Arkitekturë Peisazhi”, kanë mundësi të informohen në mënyrë të hollësishme për secilin nga modulet e programit të studimit. Plani mësimor i programit të studimit është i afishuar në ambjentet e FBM, pranë sekretarisë mësimore të departamentit. Infomacioni për kurrikulen mësimore, planin mësimor, praktikat profesionale janë të publikuara në Web, ndodhen në sekretarinë e njësisë bazë përgjegjëse për programin. (RVB, Statuti, Rregulloret përkatëse, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takim me zyrat përkatëse)</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Qendra e Karrierës dhe Alumni, ka per qëllim kryesor mbështetjen dhe orientimin i studentëve lidhur me karrierën e tyre. Ndër detyrat funksionale të saj është edhe evidentimi i të dhënave të studentëve të viteve të fundit te cikleve të ndryshme të studimeve, si edhe gjurmimin e tyre lidhur me ecurinë e punësimit. Për të lehtësuar mundësitë e punësimit të studentëve, Universiteti Bujqësor i Tiranës ka nënshkruar një sërë marrëveshesh bashkëpunimi me institucione të ndryshme. Gjithashtu edhe organizimi I panairit te punës u jep mundësi studentëve të njihen nga afër, prezantohen dhe komunikojnë me biznese të ndryshme, ofertat e tyre si dhe aftësitë që ata kërkojnë (RVB, Statuti, Rregulloret përkatëse, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takim me zyrat përkatëse, Raporti i Vlerësimit të Panairit të Karrierës për vitin 2014, Ilustrim i edicionit të tretë të ‘Panari i Karrierës në UBT)</p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Studentët kanë mundësi të marrin informacion në lidhje me: (i) organizimin e mesimit dhe strukturën e vitit akademik nëpërmjet orarit mësimor që afishohet në stenda dhe në mjediset e fakultetit si edhe në faqen zyrtare te UBT, FBM-s dhe në stendat e departamentit; (ii) logjistikën dhe infrastrukturën përmes sinjalistikes orientuese që fillon nga hyrja e universitetit dhe deri në emërtimin e godinave dhe sallave të leksioneve dhe seminareve; (iii) shërbimet mund të merret nga ZSS, sekretaria e departamentit, zyra e karrieres, etj. (RVB, Statuti, Rregulloret përkatëse, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takim me zyrat përkatëse)</p>			
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë</p>	<p>Në UBT përdoret sistemi Esse3 (RVB, Statuti, Rregulloret përkatëse, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takim me zyrat përkatëse)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X



Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë*, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.</p>	<p>Mbajtja e të dhënave statistikore në lidhje me numrin e studentëve dhe studentëve të diplomuar është një kërkesë e normuar nga aktet rregullatore të universitetit si dhe përcaktohen në Rregulloren e Brendshme të FBM, (RVB, Statuti, Rregulloret përkatëse, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takim me zyrat përkatëse)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Institucioni disponon dokumentacion të plotë periodik në lidhje me statistikat vjetore të studentëve të regjistruar, të tërhequr apo të larguar para përfundimit të programit. Sa i takon regjistrimit, ruajtjes së të dhënave dhe raportimit, përcakton mbajtjen e statistikave vjetore për të regjistruarit në program, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik. Këto të dhëna statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit të ZSS. (RVB, Statuti, Rregulloret përkatëse, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takim me zyrat përkatëse)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>FBM disponon të dhëna për regjistrimin e studentëve në regjistrin themeltar ku çdo studenti i korrespondon një numër matrikullimi. Mban regjistrin e arritjeve akademike dhe diplomave ku shënohet numri i diplomës dhe lista e notave. (RVB, Statuti, Rregulloret përkatëse, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takim me zyrat përkatëse, Evidenca për studentët e regjistruar në programin “Arkitektura Peisazhi” në 5 vitet e fundit)</p>
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Në rregulloret e studimeve përcaktohet edhe përgjegjësia për regjistrimin, ruajtjen e të dhënave dhe raportimin e statistikave vjetore për të regjistruarit. I gjithë informacioni në lidhje me studentët ruhet dhe përpunohet në dy sektorë në varësi të Rektoratit. Këta sektorë janë (i) Sektori i Zhvillimit të Kurrikulave dhe Vlerësimi Institucional me nëndarje: (a) Zyra e Studimeve dhe Studentët, Zyra e Mësimit dhe Kurrikulave, Zyra e Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional dhe (ii) Sektori i Informacionit dhe Transferimit të Njohurive me nëndarje: (a) Zyra e Informacionit dhe Statistikave, Zyra e Marrëdhënieve me Biznesin, Qendra e Karrierës dhe Alumni. ZSS ka për detyrë sigurimin e bazës së të dhënave dhe ofrimin ndaj niveleve të ndryshme të drejtimit (njësi bazë, njësi kryesore, IAL) gjithë informacionin e nevojshëm për studimet dhe studentët, grumbullimi dhe përpunimi i informacionit mbi rezultatet e arritura të procesit mësimor dhe prezantimi pranë DZHKKVI dhe Rektoratit. (RVB, Statuti, Rregulloret përkatëse,</p>

	Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takim me zyrat përkatëse, Evidenca për studentët e regjistruar në programin “Arkitekture Peisazhi” në 5 vitet e fundit)			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve	Të dhënat e ofruara nga ZSS përdoren nga Dep. i Hortikulturës dhe Arkitekturës së Peisazhit në kuadër të kërkesave për raportim të FBMs raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe nivelin e punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. Këto raporte pasqyrohen në analizën vjetore të FBMs dhe UBT-së, informacion që është i aksesueshëm për të gjithë stafin akademik pasi ai kalon miratimin nga Rektorati. Kjo analizë vjetore shoqërohet me rekomandime në lidhje me masat që duhen marrë në vitin e ardhshëm akademik për të adresuar problematikat dhe evidentuar pikat e forta të treguesve. (RVB, Statuti, Rregulloret përkatëse, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takim me zyrat përkatëse)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Përfshirja dhe angazhimi i studentëve në organet vendimmarrëse dhe këshilluese është parashikuar në Statutin e UBT. Kjo pjesëmarrje formalizohet me krijimin e Këshillit të Studentëve. Gjithashtu, studentët përfaqësohen në Senatin Akademik të Universitetit në masën dhjetë për qind të anëtarëve të senatit. Studentët përfaqësohen gjithashtu edhe në Komisionet për Sigurimin e cilësisë. Senati i UBT-së përbëhet nga 25 anëtarë, 3 prej të cilëve janë studentë. (RVB, Statuti, Rregulloret përkatëse, Takimi me Dekanin)
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Në zbatim të ligjit për arsimin e lartë, në fillim të procesit të organizimit të zgjedhjeve në universitet, departamenti parashikon të përfshijë studentët në mënyrë thelbësore në organet vendimmarrëse dhe këshilluese të institucionit. Senati i UBT-së ka në përbërje 3 nga studentët. Në Fakultetin e Bujqësisë dhe Mjedisit, bazuar në kriteret e vendosura në Statutin e UBT-së, ka të përfshirë studentë në dy Komisione të përhershme, në Komisionin e Etikës dhe Komisionin për Sigurimin e Cilësisë së Programit të Studimit dhe Kërkimit

	Shkencor. (RVB, Statuti, Rregulloret përkatëse, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takim me zyrat përkatëse)			
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	<p>Programi studimit është bazuar në aftësinë e studentëve për të përvetësuar në mënyrë sa më të përshtatshme njohuritë duke përzgjedhur një program mësimor bashkëkohor. Në vlerësimin e ngarkesës akademike të studentit janë mbajtur parasysh marrja e informacionit teorik edhe atij praktik, përmes detyrave dhe projekteve të kursit. Vlerësimi i studentit realizohet gjithëvjeter në mënyrë të shpërndarë gjatë semestrit në raportin ku 60% e vlerësimit përfitohet nga provimi përfundimtar dhe 40% e vlerësimit përfitohet nga provimet e ndërmjetme dhe detyrat apo projektet e kursit. Për të gjithë studentët që kërkojnë të transferojnë studimet ose kërkojnë të vazhdojnë një program të dytë studimi të njëjtë ose të ngjashëm, FBM bën të mundur ekuivalentimin e një pjese, programeve të plota ose diplomave të marra në institucione të tjera të vendit ose të huaja, sipas përcaktimeve në Statutin e UBT-së.</p> <p>Pranë FBM, me urdhër të Dekanit të Fakultetit, ngrihen dhe funksionojnë komisione ad hoc të Njohjes dhe Ekuivalentimit të Studimeve. Komisionet përbëhen nga tre anëtarë: zëvendës dekani për mësimin, kurrikulat dhe përgjegjësi i departamentit. (RVB, Statuti, Rregulloret përkatëse, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takim me zyrat përkatëse)</p>			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.	<p>Studentët marrin pjesë në prezantimin e punës mësimore dhe kërkimore ku kërkohet mendimi i tyre për përmirësime të mëtejshme të programeve që drejton Departamentit. Po sipas rregullores së studimeve dhe asaj për cilësinë, në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve, organizohet pyetësori studentor për cilësinë e mësimdhënies për modulet e çdo programi studimi. (RVB, Statuti, Rregulloret përkatëse, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takim me zyrat përkatëse)</p>			
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësisë/pedagogut përgjegjës.	<p>Janë hartuar një sërë dokumentash ku studenti para hyrjes në provim mund të shikojë vlerësimin gjatë vitit, procedura e ankimit. Procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës, si dhe vendimi i marrë regjistrohen në regjistrin e ankesave të studentëve që mbahet në Dekanat. (RVB, Statuti, Rregulloret përkatëse, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takim me zyrat përkatëse).</p>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Null përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Në Universitetit Bujqësor janë ngritur si pjesë e njërive ndihmëse në funksion të procesit mësimor-shkencor, sektori i mësimit, kurrikulave dhe vlerësimit institucional i cili ka pjesë përbërëse në zyrën e studimeve dhe studentëve si edhe zyra e mësimit dhe kurrikulave. (RVB, Statuti, Rregulloret përkatëse, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takim me zyrat përkatëse)
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. .	Pranë UBT është ngritur Dega e Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional e cila ka në përbërje përgjegjës për Zyrën e Studimeve dhe Studentëve. Përgjegjësi koordinon veprimtarinë e ZSS-së në nivel zyre, në bashkëpunim me Degën e Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional (RVB, Statuti, Rregulloret përkatëse, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takim me zyrat përkatëse)
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Si pjesë e njërive ndihmëse në funksion të procesit mësimor-shkencor tashmë është ngritur Sektori i Informimit dhe Transferimit të Njohurive që ka si pjesë përbërëse Zyrën e Marrëdhënieve me Biznesin dhe Qendrën e Karrierës dhe Alumni. Këto njësi varen nga Rektori i Universitetit dhe kanë lidhje të drejtpërdrejta me Zv/Rektorin për problemet e mësimit. Ndër detyrat funksionale kryesore të kësaj njësie janë edhe prodhimi dhe sigurimi i materialeve në funksion të orientimit dhe informimit të studentëve.. Studentët informohen dhe orientohen në lidhje me mundësinë e transferimit të programeve të studimeve apo të krediteve të fituara gjatë zhvillimit të tyre nëpërmjet Zyrës së Studimeve dhe Studentëve në nivel universiteti dhe nga Zyrat e Karrierës dhe Studentëve në secilin prej departamenteve. (RVB, Statuti, Rregulloret përkatëse, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takim me zyrat përkatëse).
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse	Qendra e Karrierës dhe Alumnit ka ndërtuar një bazë të dhënash të studentëve që diplomohen në UBT me synim ndjekjen e punësimit të tyre deri në pesë vjet. Proçesi i ndërtimit të portalit interaktiv të QKA është në fazën e fillimit të tij. ZMB dhe Zyra e Karrierës dhe Alumnit bashkëpunon me dekanët dhe ZSS për të hedhur informacion në databazën e të diplomuarve rishtas dhe grumbulluar informacion lidhur me kërkesat për punë dhe aktivitete të ndryshme që organizohen në bashkëpunim me bizneset; si edhe bën të njohur informacionin që lidhet me aktivitetet, ofertat për sponsorizime për studentët e ekselencës nëpërmjet publikimit në website-in e UBT-së. (RVB, Statuti,

	Rregulloret përkatëse, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takim me zyrat përkatëse)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës funksionon Dega e Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit institucional (DZHKKVI). Pjesë e strukturës së kësaj dege është Zyra e Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional (ZSCVI) e cila monitoron në mënyrë dhe vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore sipas rregullores përkatëse (RVB, Statuti, Rregulloret përkatëse, Plani strategjik i zhvillimit te UB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takim me zyrat përkatëse)
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Zyra e Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional (ZSCVI) në UBT ka një staf prej 3 pedagogësh, me përkatësisht detyrat e përgjegjës të degës, përgjegjës të ZSCVI dhe përgjegjëses së Zyrës së Mësimin dhe Kurrikulave. FBM ka njësinë e vet të sigurimit të brendshëm të cilësisëe cila funksionon në bazë të Rregullores së FBM. (RVB, Statuti, Rregulloret përkatëse, Plani strategjik i zhvillimit te UB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takim me zyrat përkatëse, Rregullore e Brendshme e FBM)
Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë administrohet nga Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë, Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor dhe Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimin Institucional e cila monitoron në mënyrë të vazhdueshme dhe vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore. Procedurat e Sigurimit të Cilësisë rishikohen periodikisht. (RVB, Statuti, Rregulloret përkatëse, Plani strategjik i zhvillimit te UB, Takimi me Dekanin,

	Takimi me Stafin Akademik, Takim me zyrat përkatëse, Rregullore e Brendshme e FBM)			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.	Komisioni Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë perbehet nga 5 anëtarë, 4 pedagogë dhe 1 student. Analiza e ecurisë së programit të studimit përfshin elementët e programit të studimit dhe në përpjthje me gjetjet dhe kërkesat bëhen përmirësime të tij. (RVB, Statuti, Rregulloret përkatëse, Plani strategjik i zhvillimit te UB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takim me zyrat përkatëse, Rregullore e Brendshme e FBM, Vendimi i konstituimit të Komisionit të Sigurimit të Cilësisë në FBM)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Asnjë përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.	Institucioni ka njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit që është Dega e Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional. Misioni i saj veç funksioneve të tjera është koordinimi dhe monitorimi i gjithë procesit mësimor, si edhe proceseve të vetëvlerësimit të të gjitha njësive të UBT. (RVB, Statuti, Rregulloret përkatëse, Plani strategjik i zhvillimit te UB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takim me zyrat përkatëse, Rregullore e Brendshme e FBM, Rregullore e DZHKKVI)
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	Fakulteti organizon në fund të çdo viti akademik rishikimin periodik të programit të studimit dhe rregullores mësimore të tij. Pasi grumbullohen të dhënat e nevojshme përgjatë vitit akademik, merren opinionet e studentëve në lidhje me zhvillimin e procesit mësimor në të gjitha modulet dhe relacioni nga pedagogët në përfundim të vitit mësimor duke evidentuar problemet dhe sugjeruar zgjidhje hartohet nje raport. Administratori i Fakultetit harton një relacion me shkrim në lidhje me sigurimin e bazës materiale dhe regjistron çdo mangësi të vërejtur. Zyra e Monitorimit të Kurrikulës në bashkepunim me Fakultetin koordinon punën për hartimin dhe paraqitjen e planeve dhe programeve të reja të studimit ose të rishikimit të planeve ekzistuese. (RVB, Statuti, Rregulloret përkatëse, Plani strategjik i zhvillimit te UB, Takimi me Dekanin, Takimi

	me Stafin Akademik, Takim me zyrat përkatëse, Rregullore e Brendshme e FBM, Manuali i Cilësisë, Rregullore e FBM)			
Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	UBT në mënyrë periodike realizon vlerësimin e performancës së pedagogëve në lidhje me zbatimin e programeve të miratuara nga departamentet dhe fakultetet Gjithashtu studentët janë pjesë e procesit të vlerësimit të performancës së pedagogëve përmes plotësimit të anketimeve që realizohen çdo fund semestri nga departamentet dhe fakultetet. Programet e studimit përmirësohen çdo fillim viti akademik duke marrë në shqyrtim vërejtjet e pedagogëve dhe studentëve. (RVB, Statuti, Rregulloret përkatëse, Plani strategjik i zhvillimit të UB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takim me zyrat përkatëse, Raport i Analizës së Punës Mësimore të UBT, rezultatet e anketimeve)			
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Raporti i rishikimit të programit të studimit analizohet nga Senati Akademik, i cili e miraton atë. Rektorati merr masat për zbatimin e planit të veprimeve sipas afateve të përcaktuara (RVB, Statuti, Rregulloret përkatëse, Plani strategjik i zhvillimit të UB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takim me zyrat përkatëse, Rregullore e FBM).			
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë	Institucioni në mënyrë të përvitshme harton raportet e veprimtarisë institucionale të cilat përmbledhin analizën e procesit mësimor me të gjithë komponentët e tij si dhe raportin e analizës së kërkimit me të gjithë komponentët e vlerësimit të tij. (RVB, Statuti, Rregulloret përkatëse, Plani strategjik i zhvillimit të UB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takim me zyrat përkatëse, Raport i Analizës së Punës Mësimore të UBT)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtijshme të studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësi e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të	UBT u akreditua nga ASCAL me vendimin nr. 11, dt 7.04.2017. FBM ka njësinë e brendshme të cilësisë që është Komisioni për Sigurimin e Cilësisë së Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor me pjesmarrje të studenteve. Ky komision, në bashkërendim me njësinë kryesore dhe njësinë

<p>akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>bazë përgjegjëse për programin e studimit ndërmarrin procese të rivlerësimit të kurrikulave, vlerësimin e cilësisë së programeve mësimore, etj.</p> <p>Në nivel fakulteti ka pasur vetëvlerësimepor nuk ka pasur vlerësime të jashtme dhe auditime. (RVB, Vendimi i Akreditimit Institucional të UBT, Procedura për rishikimin e kurrikulave, rifreskimin e programeve mësimore, Raporti i Vetëvlerësimit të FBM 2014, Raporti i Vlerësimit të Brendshëm të dHAP i vitit 2014, Raportet e analizës së mësimin dhe kërkimit në 5 vitet e fundit)</p>			
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>FBM përdor metoda vlerësimi dhe instrumente për mbarëvajtjen e procesit të mësimdhënies. Per me shume duhet te kryhet vleresim i brendshem 360 grade, (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik)</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si: vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Dega e Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional me zyrat e ZSCVI, ZMK e ZSS, monitoron analizat dhe vlerësimin e proceseve akademike që kontrollohen gjatë vitit dhe rezultatet e tyre i raporton pranë rektoratit dhe dekanateve të fakulteteve. Gjithashtu zyra përgatit në mënyrë të përvitshme analizën e veprimtarisë mësimore të Universitetit dhe ja referon atë Senatit Akademik. Njësia kryesore përgjegjëse për programin e ciklit të dytë “Master Profesional në Arkitekturë Peisazhi”, mbështetur në rregulloren e saj organizon në fund të çdo viti akademik rishikimin periodik të programit të studimit dhe rregullores mësimore të tij. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Rregullore e DZHKKVI)</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Njësia bazë përgjegjëse (d.HAP) për programin “Master Profesional në Arkitekturë Peisazhi” në fund të çdo viti akademik kryen analizën e performancës akademike të stafit sipas procedurave të statutit dhe rregulloreve të UBT. d.HAP aplikon pyetësorin për vlerësimin e stafit që aplikohet në përfundim të semestrit, nëpërmjet edhe me pyetësorin e studentëve, pyetësorin e stafit akademik. Duhet aplikuar vlerësimi 360 grade, duke përfshirë vlerësimin pedagog-pedagog. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me studentët)</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi VI.4				
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.				
Kriteret		Vlerësimi i ekspertëve		
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.		Institucioni ka miratuar në 2018 Manualin e Cilesise, ku përcaktohet roli i strukturave akademike dhe administrative lidhur me sigurimin e cilësisë. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me struktura te sigurimit te cilesise, Manualin e Cilësisë)		
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.		Institucioni ka miratuar në 2018 Manualin e Cilesise, ku përcaktohet roli i strukturave akademike dhe administrative lidhur me sigurimin e cilësisë. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me struktura te sigurimit te cilesise, Manualin e Cilësisë)		
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.		Studentët përfshihen në këtë proces nëpërmjet angazhimit në plotësimin e pyetësorëve periodikë, por edhe duke qënë antarë të Komisionit të sigurimit të cilësisë në FBM. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me struktura te sigurimit te cilesise, Manualin e Cilësisë)		
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.		FBM garanton respektimin e barazisë dhe integritetit të stafëve dhe studentëve. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me struktura te sigurimit te cilesise, Manualin e Cilësisë)		
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vjera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj		Sigurimi i brendshëm i cilësisë në UBT, është ndërtuar duke respektuar kërkesat ligjore. Per momentin nuk ka partnere te perfshire si pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë dhe mendime në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me struktura te sigurimit te cilesise, Takimi me studentët)		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Politikat dhe strategjitë e sigurimit dhe vlerësimit të cilësisë janë transparente dhe bëhen publike për studentët. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me struktura të sigurimit të cilësisë, Takimi me studentët, Rregulloret përkatëse, Statuti i UBT, Rregullore e brendshme e FBM, Manuali i Cilësisë).			
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Informacionet në lidhje me politikat dhe praktikatat që lidhen me sigurimin e cilësisë në UBT janë të aksesueshme përfshirë edhe studentët duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me struktura të sigurimit të cilësisë, Takimi me studentët)			
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Gjatë takimit në departament u permenden rastet kur në statistikat e anketimeve nga studentët kane hasur pedagogë me nivele të ulta vlerësimi merren masa duke i mbikqyrur dhe duke ju lënë detyra të caktuara sipas rasteve konkrete			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Raportet e vlerësimit të cilësisë japin rekomandime për përmirësimin e nevojave.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	Institucioni përmes pyetësorëve dhe përmes mbledhjeve të hapura të asamblesë ndërgjegjëson studentët dhe personelin për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimit të cilësisë në universitet. (RVB, Takimi me Dekanin, Takimi me Stafin Akademik, Takimi me struktura të sigurimit të cilësisë, Takimi me studentët)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional “Arkitekture Peisazhi” të Institucionit të Arsimit të Lartë “UBT”

1. Pikat e forta dhe afirmime

- Programi i përgjigjet nevojave akute për profesionistë të sektorit të arkitekturës së peisazhit
- Kompetenca të stafit akademik dhe bashkëpunimi me Fakultetin e Arkitekturës
- Infrastrukturë didaktike në UBT dhe bashkëpunimi me universitete partnere dhe biznese private
- Perjekje të vazhdueshme për një kurrikul koherente me nevojat e tregut.

2. Pika të dobta

- Mungon një strategji afatgjatë për zhvillimin e programit të studimit
- Mungojnë raportet analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit
- Nuk ka një studim të mirëfillte të tregut për këtë program studimi
- Vlerësimi 360 grade duke përfshirë dhe aplikuar vlerësimin pedagog-pedagog

3. Rekomandime

- Hartimi i një strategjie afatgjatë për zhvillimin e programit të studimit MP Arkitekturë Peisazhi
- Shtimi në planin mesimor të peshës së moduleve të projektimit arkitektonik
- Shtimi i perpjekjeve për përmirësimin e mësimdhënies, ato të jenë me interaktive.
- Shtimi i stafit akademik me profesion arkitekt
- Shtimi i kontrollit të departamentit për të shmangur mbivendosjet në syllabuse si dhe mësimdhënie
- Vazhdim i investimeve në infrastrukturë për realizimin e praktikave mësimore, zgjerimi i bashkëpunimit me sipërmarrje private
- Shtimi i financimeve për studime dhe trainime të stafit akademik dhe studentëve dhe promovim i programit të studimit për shtese buxheti, për tregun e punës me të dhëna parësore (anketime, etj.)
- Shtimi i perpjekjeve për forcimin e kontakteve me bizneset, për orientimin dhe këshillimin e karrieres, dhe për konsolidimin e mëtejshëm të alumnit.
- Infrastruktura në dispozicion të këtij programi, duke përfshirë këtu labororet dhe bibliotekën me literature përkatëse.

Conclusions of the evaluation of the second cycle study program, professional master "Landscape Architecture" of Higher Education Institution "Agricultural University of Tirana"

1. STRENGTHS AND AFFIRMATIONS

- The program responds to the acute needs of professionals in the landscape architecture sector
- Competences of the academic staff and cooperation with the Faculty of Architecture
- Didactic infrastructure at UBT and cooperation with partner universities and private businesses
- Continuous pursuit of a curriculum consistent with market needs.

2. WEAK POINTS

- There is no long-term strategy for developing the study program
- There are no analytical reports of the benefits from cooperation agreements
- There is no proper market study for this study program
- 360-degree assessment by incorporating and applying teacher-to-teacher evaluation

3. RECOMMENDATIONS

- Development of a long-term strategy for the development of the MP Landscape study program
- Adding to the curriculum the weight of the architectural design modules
- Increasing efforts to improve teaching make them more interactive.
- Increase of academic staff with Architects.
- Increased departmental control to avoid overlapping syllabuses and teaching
- Continued investment in infrastructure for the implementation of teaching practices, expanding the scope with private enterprises
- Increase funding for studies and training of academic staff and students, promotion of the study program for additional budget for the labor market with primary data (surveys, etc.)
- Increasing efforts to strengthen business contacts, career orientation and counseling, and further alumni consolidation.
- The available infrastructure for this program, including the laboratories and library with relevant literature.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X